

**TABELË E FUNKSIONEVE, DETYRAVE DHE KOMPETENCAVE TË
DREJTORËVE/IVE, ARSIMIT, KUALIFIKIMET E DREJTUESVE**

Drejtoria/Struktura	Detyrat funksionale	Arsimi dhe kualifikimet e drejtuesve/CV
Këshilli Drejtues	Këshilli Drejtues është organi më i lartë drejtues i AKEP-it, i zgjedhur nga Kuvendi Republikës së Shqipërisë. Këshilli Drejtues, ushtron veprimtarinë e tij vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale dhe të pavarur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024 për komunikimet elektronike dhe postare dhe ligjit 46/2015 për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.	https://akep.al/rret h-akep/
Kabineti Kryetarit: Drejtor Kabineti Këshilltar	Për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave Kryetari ndihmohet/asistohet nga funksionarët ndihmës në përbërje të Kabinetit.	Sara Xhumbari Altin Petre
Drejtoria e Çështjeve Ligjore Drejtor Sektori i Shërbimeve Ligjore: Përgjegjës sektori Specialist Sektori i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve: Përgjegjës sektori Specialist	Drejtoria e Çështjeve Ligjore, realizon kryerjen e analizave të nevojshme ligjore për interpretimin e ligjit në funksion të realizimit sa më efektiv të të gjithë proceseve të punës si dhe bashkëpunon për hartimin e ndryshimeve të legjislacionit dhe të akteve rregullatore të cilat diktohen nga evolucioni teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor në fushën e komunikimeve elektronike. Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë të Çështjeve Ligjore, është kryerja e detyrave për sigurimin e mbështetjes në aspektin ligjor të veprimtarisë së AKEP, gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve rregullatore dhe administrative të AKEP-it.	

Drejtoria Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike Drejtör Sektori i TIK dhe Domain: Përgjegjës sektori Specialist Sektori i Sigurisë së Rrjeteve dhe Sigurisë Informatike: Specialist	Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike (DTSI) ka objekt të veprimtarisë së saj mirëmbajtjen e rrjetit LAN dhe WAN të AKEP; suport teknik për stafin e brendshëm; menaxhimin e problemeve komplekse në lidhje me harduerin dhe softuerin e sistemeve nën administrimin e AKEP; administrimin e Sistemit të Përqendruar të Informacionit mbi infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike ATLAS, faciliteteve shoqëruese, shërbimeve broadband dhe të drejtës së kalimit; garantimin e sigurisë kibernetike duke koordinuar dhe trajtuar incidentet e sigurisë në rrjetet dhe sistemet e informacionit, identifikimin dhe përgjigjen ndaj incidenteve dhe rreziqeve të sigurisë; vlerësimi i profilit të rrezikut në nivel kombëtar, për të gjithë furnizuesit përkatës dhe ofruesit e pajisjeve të rrjetit 5G ose të gjeneratës së re për operatorët; administrimin e domain cc.TLD.al, nëndomainet e tij, portabilitetin e numrit etj.	
Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Kontrollit Drejtör Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit: Përgjegjës sektori Specialist Sektori i Kontrollit: Përgjegjës sektori Inspektor Sektori i Statistikave; Specialist	Objekti i punës së Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Statistikave dhe Kontrollit është kryerja e detyrave në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve/të drejtave të përdoruesve fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare, të dhënat statistikore të sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe kontrolli/inspektimi i veprimtarisë së subjekteve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, shërbime postare, regjistrim të domaineve cc.tld.al, dhe që janë objekt i mbikëqyrjes nga AKEP sipas akteve ligjore në fuqi, si Ligji 54/2024 dhe Ligji 46/2015, dhe aktet nënligjore përkatëse të nxjerra në zbatim të tyre.	Altin Rrapaj

Drejtoria Rregullatore dhe e Mbikëqyrjes së Tregut Drejtor Sektori i Analizës së Tregjeve dhe Aksesit: Përgjegjës sektori Specialist Sektori i Shërbimit Postar: Përgjegjës sektori Specialist	Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregjeve është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe kompetencave sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim garantimin e konkurrencës së ndershme, mbrojtjes së interesave të përdoruesve fundorë dhe ofrimit të shërbimit universal në të dy sektorët e komunikimeve elektronike dhe atij postar.	Gazmir Mani
Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme Drejtor Sektori i Monitorimit të SRF dhe Treguesve të Cilësisë QOS: Përgjegjës sektori Specialistë (monitorues) Sektori i Menaxhimit SRF dhe Numeracionit: Përgjegjës sektori Inspektorë Sektori i Autorizimeve dhe Licencave: Përgjegjës sektori Specialist	Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme ka objekt të veprimtarisë së saj, administrimin eficient të spektrit të radiofrekuencave dhe numeracionit në përputhje me rregulloret dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare; dhënien e të drejtave të përdorimit të radiofrekuencave dhe numeracionit; monitorimin e spektrit frekuencor nëpërmjet stacioneve të monitorimit në distancë dhe stacioneve të lëvizshme për të siguruar përdorimin eficient dhe ligjor të spektrit; monitorimin e treguesve të cilësisë së shërbimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike për shërbimet fiks, i lëvizshëm dhe internet, zbatueshmërinë e standardeve teknike; vlerësimin dhe regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm; administrimin e bazës së të dhënave elektronike të sipërmarrësve; dhënien e autorizimeve sipas ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”; dhënien e licencave/ certifikatave sa i takon shërbimeve të radiondërlidhjes në vijën bregdetare, licencave të stacioneve radio në avion dhe licencave radioamatore; njohjen e konformitetit për pajisjet radio të telekomunikacionit; studimin e vendimeve, rekomandimeve, standardeve e konventave ndërkombëtare në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj etj.	

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë Drejtor Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit: Përgjegjës sektori Specialist Specialist Sektori i Integritetit dhe Marrëdhënieve me Jashtë: Përgjegjës sektori Specialist	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë ushtron veprimtarinë e saj në fushën e administrimit të burimeve njerëzore dhe të marrëdhënieve institucionale brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, përfshirë legjislacionin për administratën publike, marrëdhëniet e punës, arkivin shtetëror, protokollin shtetëror dhe integrimin europian. Objektivi i kësaj drejtorie është të sigurojë një administrim të standardizuar dhe të efektshëm të kapaciteteve njerëzore të institucionit, si dhe të zhvillojë, koordinojë dhe mbikëqyrë komunikimin dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale e ndërkombëtare të AKEP-it.	Jonida Koçi
Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtor Sektori i Financës: Përgjegjës sektori Specialist Sektori i Shërbimeve Mbështetëse: Përgjegjës sektori Administrator i godinës Shofer Pastrues	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka për qëllim sigurimin e mbështetjes së plotë financiare, logjistike dhe administrative për realizimin me efektivitet të funksioneve rregullatore dhe operacionale të AKEP. Kjo drejtori ka në fokus menaxhimin financiar, kontabilitetin, kontrollin e brendshëm financiar, si dhe sigurimin e shërbimeve të përgjithshme mbështetëse që garantojnë funksionimin e pandërprerë dhe efikas të institucionit.	